



BULETINI MUJOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE

(Pasqyra 14/Sh)

DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

TETOR, 2019

Buletini Mujor i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin Mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14/Sh. Ai plotësohet në Pasqyrë në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14/Sh për muajin tetor 2019 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) në rrethe.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike gjatë muajit tetor 2019 zënë 33.86 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14/Sh, dhe paraqesin një incidencë 242.49/100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që në nivel kombëtar, helmimet ushqimore paraqesin një incidencë (4.86/100.000 banorë). Rrethet Berat, Bulqizë, dhe Kukës mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rretheve të diagnozës së saktë klinike, dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.

Në tetor 2019, në fshatin Postribe, Shkodër ka ndodhur një helmim ushqimor nga konsumi i një sanduichi të përgatitur në një Fast Food brenda oborrit të shkollës “Adem Haxhija”. Pacientët, të gjithë nxënës të kësaj shkolle, janë paraqitur në Institucionet e Kujdesit Shëndetësor Shtetëror në Shkodër dhe në Postribe me probleme gastrointestinale. Mostrat e feceve u ekzaminuan në “Laboratorin e Enterobakterieve” (ISHP) pas 24 orëve u evidentua prania e bakterieve Salmonella (6.10.2019) dhe brenda 48 orëve përcaktoi agjentin shkaktar Salmonella Enteritidis (7.10.2019). Pra në këtë rast kemi të bëjmë me një helmim ushqimor të shkaktuar nga Salmonella Enteritidis. NJVKSH-ja Shkodër ka marrë masat përkatëse.

Gjatë muajit tetor 2019 janë raportuar 54 raste me Salmonelozë jotifoide, të konfirmuara (1.93/100.000 banorë). Raste me Salmonelozë jotifoide kemi në Shkodër (2.71/10.000 banorë), Tiranë (0.07/10.000 banorë) dhe Dibër (0.48/10.000 banorë).

Gjatë muajit tetor 2019 janë 51 raste (1.82/100.000 banorë) të raportuara me Shigelozë nga rrethet Shkodër, Dibër dhe Kukës. Rrethi i Shkodrës vazhdon të ketë peshën kryesore të incidencës së Shigelozës për muajin tetor 2019 me 47 raste (2.83/10.000 banorë) të konfirmuara në Laboratorin Mikrobiologjik të NJVKSH-së Shkodër, që u përkasin grup-moshave të ndryshme.

Gjatë muajit tetor janë raportuar dy raste të konfirmuara të grup moshës 0-4 vjeç, me Tifo abdominale nga rrethi Lezhë. Diagnoza është konfirmuar për të dyja rastet nga një laborator privat në Tiranë. Janë marrë kampione uji të pijshëm në vatër dhe në zonën përreth, të cilat kanë rezultuar brenda normave si nga ana fiziko-kimike dhe mikrobiologjike. Koprokulturat e personave të kontaktit kanë rezultuar negativ.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin tetor 2019

(Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste tetor 2019	Incidenca tetor 2019 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	2	0.07
Salmonelozë	54	1.93
Shigelozë (Disenteri bacilare)	51	1.82
Dizenteri amebike	1	0.04
Helmime ushqimore	136	4.86
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	6546	233.77
Sëmundje diarreike në total	6790	242.49

2. Sëmundjet e parandalueshme nga vaksinat (EPI)

2.1. Fruthi

Gjatë muajit tetor 2019 nuk kemi raste të diagnostikuara me fruth, ndërkohë që në muajin tetor 2018 në kuadrin e vazhdimësisë së epidemisë së fruthit janë dyshuar në total 37 raste, prej të cilave janë konfirmuar me IgM pozitiv vetëm 18 raste. Nga këto 17 raste i përkasin rrethit të Tiranës dhe 1 rast rrethit të Krujës. Rastet pozitive i përkasin kryesisht grup-moshës pediatrike (0-14 vjeç) me 11 raste, nga të cilat 7 raste janë në grup-moshën nën 2 vjeç (7 raste). Kjo vazhdon të jetë grup-mosha më e prekur për shkak edhe të mosvaksinimit, dhe kontaktit apo vizitës së mëparshme të tyre në shërbimin pediatrik të QSUT-së. Të gjitha rastet janë konfirmuar në Laboratorin e Virologjisë, në ISHP.

Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve të dyshuara për fruth sipas datës së fillimit të rashit, tetor 2018



2.2. Tuberkulozi Pulmonar

Bazuar në të dhënat e Pasqyrës 14/Sh, gjatë muajit tetor 2019, janë raportuar 21 raste të reja me Tuberkuloz Pulmonar (TB) (0.75/100.000 banorë). Rastet pulmonare sputum pozitiv janë raportuar nga rrethet: Tiranë, Bulqizë, Fier, Lezhë, Pukë, Shkodër dhe Vlorë. Rastet e raportuara në muajin tetor i përkasin moshës mbi 20 vjeç. Bazuar në të dhënat e Pasqyrës 14/Sh, gjatë muajit tetor 2019, janë raportuar 8 raste të reja me Tuberkuloz Ekstrapulmonar nga Tirana (0.12/10.000 banore) dhe një rast nga Durrësi.

3. Zoonozat

Gjatë muajit tetor 2019, me anë të Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14/Sh nga NJVKSH janë raportuar 6 raste me Brucelozë, 2 prej tyre janë të konfirmuara. Rastet janë raportuar nga rrethet Kolonjë, Kukës, Librazhd, Pogradec dhe Tepelenë.

Gjatë muajit tetor vihet re një rritje e rasteve të raportuara me Leptospirozë (.8 raste). Përkatësisht, nga 1 rast kanë raportuar Lushnja, Pogradeci dhe Shkodra, 2 raste Fieri dhe 3 raste janë denoncuar nga NJVKSH Tiranë.

**Tabela 2: Frekuenca dhe incidencat e sëmundjeve Zoonotike në tetor 2019
(Incidenca raste/100.000 banorë)**

	Raste tetor 2019	Incidenca tetor 2019 (raste/100.000 banorë)
Antraks (Plasje)	0	0
Brucelozë	6	0.21
Leptospirozë	8	0.29
Leishmaniazë viscerale	0	0
Leishmaniazë kutane	0	0

4. Hepatitet virale

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit tetor 2019, janë raportuar në total 27 raste me hepatite virale akute (Incidenca 0.96/100.000 banorë), nga të cilat 3 raste janë hepatite virale të paspecifikuara, 21

raste Hepatite Virale B (HBV), nga te cilat 18 janë të konfirmuara në laboratorët e NJVKSH-së. Numri i lartë i rasteve të konfirmuara me HBV, 18 raste në Tiranë, lidhet me numrin e lartë të testimeve për marrjen e librezave shëndetësore dhe shumë prej rasteve janë bartës të Hepatitit B.

Në lidhje me Hepatitin Viral C (HCV) në Pasqyrën 14/Sh janë raportuar 3 raste, dhe 1 rast është i konfirmuar nga NJVKSH Tiranë.

5. HIV/AIDS

Në muajin tetor 2019 janë kryer në total 9 ekzaminime për HIV në Njësinë e Laboratorëve në ISHP, 6 meshkuj dhe 3 femra. Nga këto ekzaminime, 5 prej tyre kanë rezultuar pozitive (4 meshkuj dhe 1 femër). Rastet pozitive i përkasin moshave të ndryshme, përkatësisht nga 24 deri 41 vjeç. Rastet pozitive janë nga rrethet Tiranë, Kuçovë, Lushnjë dhe Burrel. Mostrat e gjakut që kanë rezultuar pozitive kanë ardhur në ISHP nga Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë, Spitali Infektiv QSUT, Laboratori Intermedica dhe vullnetar.

6. Malarie

Gjatë muajit tetor kemi patur një rast të konfirmuar me malarie, një shtetas shqiptar nga Tirana i cili ka qenë në Kamerun dhe Zimbabve për dy muaj dhe 10 ditë pas kthimit në Shqipëri ka shfaqur këto shenja klinike ethe, temperaturë, të vjella dhe djersë profuze. Pacienti ka marrë kinin gjatë qëndrimit të tij atje. Pacienti është dyshuar për malarie në Spitalin Infektiv të QSUT-së, dhe nga ekzaminimi i kryer në Laboratorin e ISHP-së ka rezultuar pozitiv me malarie

INSTITUTI I
SHËNDETIT PUBLIK

DEKSI